



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 248, Datë 18.11.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“MOUNTAIN’S GREEN ENERGY” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2346/1prot., datë 14.11.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2346 prot., datë 05.11.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, Qarku Shkodër, me kapacitet të instaluar 1975 kW.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3 gërmat “a”, “b” dhe “c”; si dhe për pikën 2.1 gërmat “b”, “c”, “d”, dhe “f”.
- Rezulton se shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.:

- Me shkresën e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) nr. 3222/2 prot., datë 26.07.2021, ka marrë miratimin për transferimin e të drejtës për ndërtimin e burimit gjenerues të energjisë fotovoltaike me kapacitet prodhues 1975 kW, në zonën Gomsiqe, Vau i Dejës, si dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në Miratimin Përfundimtar nr. 400913 prot., datë 04.10.2017 dhe kontratave të nënshkruara me MIE, nga shoqëria “IN FOOD” sh.p.k. tek shoqëria “Mountain’s Green Energy” sh.p.k.
 - Ka depozituar në ERE shkresën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. “Miratim pikë lidhje Central Fotovoltaiik” me nr. 7247/3 prot., datë 03.08.2024, drejtuar shoqërisë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k., në të cilën përcaktohet se referuar kërkesës së shoqërisë, për transferim të së drejtës për ndërtim dhe ndryshim të emërimit në miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltaiik me adresë në Gomsiqe, Vau i Dejës, me kapacitet 1975 kW, miratohet lidhja e këtij centrali në rrjetin e shpërndarjes.
 - Ka depozituar një VNM Paraprake, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), në datën 07.09.2017, për Personin Juridik “IN FOOD” sh.p.k. për të zhvilluar projektin: “Central diellor fotovoltaiik”, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau i Dejës, Qarku Shkodër. Në këtë dokument nuk është përcaktuar një afat kohor për vlefshmërinë e kësaj VNM-je por në pikën 3.2. përcaktohet se: *ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të marrë miratimin nga institucionet përkatëse për këtë lloj aktiviteti, ndërsa në pikën 3.4 përcaktohet se: ky vendim është i vlefshëm pasi subjekti të bëjë ndryshimin e statutit të tokës nga tokë arë në tokë truall sipas akteve ligjore në fuqi.*
- Nga ky aplikim nevojitet të plotësohet dhe informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të bëjë saktësimin e njërive gjeneruese dhe kapacitetin e secilës prej tyre, duke mbajtur në konsideratë kapacitetin total të centralit të miratuar në kontratën me MIE-n.
- **gërma “e”**: Shoqëria duhet të dokumentojë në ERE për plotësimin e kushtit të VNM-së Paraprake, për ndërrimin e statusit të tokës nga tokë arë në tokë truall. Po ashtu, vlerësohet që shoqëria të bëjë me dije si është vepruar nga ana e saj me zbatimin e afateve të vendosura nga MIE në lidhje me ndërtimin dhe vënien në operim të centralit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Mountain’s Green Energy” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 1 975 kW, me vendndodhje në Gomsiqe, Bashkia Vau Dejës, për një afat 30-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Mountain’s Green Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI